

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Adzic nuk donte t'i shënonte Juves": teoria e komplotit evidenton hezitimin e lojtarit të huazuar te Sassuolo
ADRESA	https://lapsi.al/adzic-nuk-donte-t-i-shenonte-juves-teoria-e-komplotit-evidenton-hezitim-in-e-lojtarit-te-huazuar-te-sassuolo-i1093693
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:50:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	24749049e6531d04713b48db1767b9b3e67a4bb02810bd330ebb1af1f5821322
TEKSTI	31950d60d74f7c098671b164d47ccc163e34528ec2fcd6c13327d0e5fe1e983f
PAMJA	4e3d085ddfbcd056bff95f3ffa9ea11e0e0ee4f09145d70369c81e780dc6c48b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	be870a761127427c16e7cd3e8bd463cb20b83dee6a94aae86a1302f39241cb39
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/be870a761127427c16e7cd3e8bd463cb20b83dee6a94aae86a1302f39241cb39

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

"Adzic nuk donte t'i shënonte Juves": teoria e komplotit evidenton hezitimin e lojtarit të huazuar te Sassuolo

Goli i fitores së skuadrës së teknikut Aquilani u shënua nga Vasilije Adzic, i cili është ende në pronësi të klubit bardhezi dhe muajin e kaluar u huazua te skuadra jeshilzi kundrejt pagesës prej 500 mijë eurosh.



LAPSI.AL • 14 SEPTEMBER 2026



Humbja tashmë e dhimbshme e Juventus në transfertën ndaj Sassuolos – e pësuar në frymën e fundit pasi kishte rikuperuar dy herë disavantazhin, ku herën e fundit vetëm tre minuta para golit final në minutën e 94' – u bë edhe më e dhimbshme nga rrethanat që goli i fitores së skuadrës së teknikut Aquilani u shënua nga Vasilije Adzic, i cili është ende në pronësi të klubit bardhezi dhe muajin e kaluar u huazua te skuadra jeshilzi kundrejt pagesës prej 500 mijë eurosh. Talenti 20-vjeçar malazez nuk është konsideruar qartësisht nga Spalletti dhe drejtuesit si një lojtar tashmë të gatshëm dhe të dobishëm për ekipin e parë: prej këtu erdhi vendimi për ta dërguar të "bëhej" dhe të gjente minuta diku tjetër.

Vasilije Adzic nuk feston pas golit të shënuar në minutën e fundit

Në ndeshjen e luajtur të dielën në mbrëmje në Mapei Stadium, Adzic u aktivizua në mes të pjesës së dytë në vend të Thorstvedt, duke u shndërruar në heroin e ditës për Sassuolon në minutën e 94', kur mposhti portierin Vicario në përfundim të një kundërsulmi që e gjeti të pambuluar në mënyrë të pafalshme skuadrën e teknikut Spalletti, e cila sapo kishte arritur barazimin 2-2. Skuadrat ishin shtrirë në të gjithë fushën dhe të lodhura, topi i humbur nga (sërish) i dobëti Kolo Muani në zonën e skuadrës emiliane shkaktoi ndryshimin e zotërimit të topit në këmbët e një Matic të shkëlqyer, i cili pasoi për Laurientë, që nga e djathta i dha topin Adzic. Malazezi vlerësoi për disa çaste se çfarë duhej të bënte dhe, pasi pa se Douglas Luiz nuk po afrohej për ta mbyllur hapësirën ndaj tij, mposhti Vicario -n me të djathtën.

? ● The Goal that gave SASSUOLO the win against JUVENTUS ?

Where are the defenders? What a beautiful finish from VASILJE AdŽIĆ @UEFA
pic.twitter.com/HygT9PYPsX

— Jiggy Tv (@nji168433) September 13, 2026

ide



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

22°C

KËMBIMIEURO

91.80

aktuale

08:10

Shtatori ndez protestat/
Qytetarët rikthehen në shesh,
107 ditë mobilizim kundër
qeverisë

22:18



Protestuesit i zënë pritë në
rrugë Belinda Ballukut
(VIDEO)



TIA dhe Vodafone sjellin
teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndriqe Lapsin edhe në




Me interes nga publiku

Teoria e komplotit jashtë vendit: “Adzic nuk donte të shënonte”

Ai moment hezitimi i Adzic – krejtësisht normal për të kuptuar nëse do të ishte më e përshtatshme t’ia pasonte topin në qendër të zonës njërit mes Bowie e Dominguez, të cilët kishin ndjekur aksionin, me vetëm Bremer mes tyre – u shndërrua në shkëndijën që ndezi jashtë vendit një teori komploti, sipas së cilës i riu që erdhi te Juve nga Buducnost dy vite më parë për 5.3 milionë euro plus 2 milionë bonuse, kishte “bërë gjithçka për të mos shënuar” ndaj skuadrës që ende zotëron kartonin e tij dhe ku ai ëndërron të rikthehet për t’u bërë një shtyllë e së ardhmes.

“Adzic nuk donte të shënonte, po priste që dikush t’ia merrte topin” është një nga komentet e postuara në X. Dhe më tej: “Adzic pothuajse nuk donte të shënonte golin vendimtar, mbani mend që është i huazuar nga Juventus”, “Adzic u përpoq dy herë ta kursente Juven, por pa Douglas Luiz të mbronte si një fëmijë 5-vjeçar dhe iu desh ta mbyllte ndeshjen”.



Po, Douglas Luiz: zgjedhja e brazilianit për të mos ndërhyrë, duke mos kuptuar se pas tij Bremer kishte rikuperuar pozicionin ndaj Bowie-t, është gjysma tjetër e diskutimit në rrjetet sociale pas ndeshjes. Një sjellje që, së bashku me qëndrimin e tij në fushë, ka shkaktuar komente të ashpra ndaj mesfushorit, të cilin Spalletti e ka rikthyer në qendër të projektit të Juves pas huazimeve te Nottingham Forest dhe Aston Villa.

Douglas Luiz's poor defending on Adžić's winning goal went viral, with many English fans commenting on it. ??? pic.twitter.com/DmVpuZ2cJv
— Forza Juve | ?? (@theFJEN) September 14, 2026

“Douglas Luiz është një siguri e futbollit, atij i duhej vetëm të ndiente sërish besimin”, kishte thënë trajneri në prag të ndeshjes në Mapei Stadium. Shumë tifozë bardhezinj nuk mendojnë të njëjtën gjë pas humbjes ndaj Sassuolos, dhe këtu nuk kanë lidhje komplotet imagjinare dhe qesharake.

Të këshilluara



Tifozët kërkojnë Antonio Conte në pankinë, Carnevali: “Nuk kemi ndërmend të largojmë Spallettin”

Pas katër javësh kampionat, Juventus është tashmë shumë larg kreut të renditjes së Serie A dhe pankina e teknikut Luciano Spalletti nuk duket më aq e sigurt.



Pse “Çunat e Londrës” po stepen në të investuarin në Shqipëri, Daily Mail gjurmon konfiskimet



Protestuesit i zënë pritë në rrugë Belinda Ballukut (VIDEO)



Kurti prezanton emrat e qeverisë së re të Kosovës



“Takimi u kthye në monolog”/ Aktorja Egle Ceno: Rama më tha dil jashtë nga salla



Maran rrëfëhet në intervistën e pazakontë, nga tava e dheut te gjuha shqipe: "Avash-avash"

Rolando Maran rrëfen muajt e parë në Shqipëri dhe zbulon një anë më personale, larg presionit të rezultateve dhe ndeshjeve të Kombëtares.



Kore për Diogo Jota-n për të provokuar Neves: "Shpresoj të mos shkojnë të luten pas asaj që bënë"



United i tërbuar, plasin polemikat për golin e Haaland: u favorizua City, VAR ka bërë një gabim

City ka fituar derbin e Mançesterit me një gol që, pas vërshtimit të fundit, është kthyer në një çështje arbitrimi. Pro Ref i ka kërkuar falje United.



Spalletti ironi me gazetarin drejtpërdrejt në Sky: "Mos qaj". Përgjigjja: "As mos të të shkojë mendja"

Përpara se të trajtonte temat taktike dhe teknike të Sassuolo-Juventus në transmetim televiziv, Luciano Spalletti dhuroi një përballje të papritur me gazetarin e Sky, Giovanni Guardalà.



Dygolëshi çlirues e paradoksi Zhegrova: nota më e lartë e Juventus kundër Sassuolo nuk luan në Europë

Edon Zhegova la gjurmët e para te Juventus, jo më si lojtari që humbi këtë apo atë mundësi, por si një lojtar që shënoi golin e parë në kampionat me bardhezinjtë, madje dygolëshin e parë.





Dy golëshi i Nikajt rrëzon kampionët e Egnatias: Elbasani merr fitoren e parë, polemika për dy episode penalltie



Bayern vuan me skuadrën e qytezës me 13 mijë banorë: Elversberg dorëzohet vetëm ndaj Kane

Kampionët në fuqi të Bayen Munich triumfojnë 2-1 në fushën e Elversberg, skuadër e sapo ngjitur në Bundesligë, falë golit vendimtar të Kane në pjesën e dytë.



City turpëron United në derbi, e mposht me 10 lojtarë: Foden përjashtohet, por e zgjidh Haaland

Fitorja e katërt në katër ndeshje për Manchester City të drejtuar nga Enzo Maresca, i cili, pavarësisht se luajti me një lojtar më pak për 70 minuta, mposht 1-0 Manchester United falë një golit të Erling Haaland në minutën e 60'.



Yamal një spektakël, Barcelona në krye me pikë të plota: mbrojtja gafaxhie e Flick pëson dy gola nga Levante

Java e pestë në La Liga nuk ndryshon hierarkitë në elitën e futbollit spanjoll, pasi Barcelona përgjigjet në të njëjtën mënyrë dhe e rikthen Real Madrid 3 pikë pas

Me sytë katër



11:43

Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

Matthew Exton, një ish-avokat 43-vjeçar dhe ish-prokuror lokal në Ohajo, u shpall fajtor për tentativën e vrasjes së ish-gruas ...



PAMJET/ Shoferi ishte pa ndjenja, polici jashtë detyrës ndalon makinën

11:17



A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

16:47



"Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56



VIDEO/ Batutat e Ramës me Altinin nga Peza: Ky nuk është socialist, por...

23:04

SPORT

→ Të tjerë artikuj





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.